



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport

Mbledhja nr.18

Prishtinë, më 01.07.2015, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ARSIM, SHKENCË, TEKNOLOGJI,
KULTURË, RINI DHE SPORT**

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, kryetar, Salih Morina, Srdjan Popović, Ismajl Kurteshi, Shpejtim Bulliqi, Shukrije Bytyqi, Bekim Haxhiu dhe Mufera Sinik.

Mungoi: Teuta Haxhiu.

Pjesëmarrës të tjerë: Dagmar Fuchs Schmitz-GIZ, Sokol Elshani-GIZ, Blerta Zogiani-GIZ, Blendina Krasniqi- UNDP (praktikante), Amire Qamili-BIRN, Tringa Bytyqi- GLPS, Ukë Gashi- ZPRK, Sanije Berisha-OSBE, Luljeta Krasniqi-OSBE, Albana Bajrami-RTK Radio.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

Mbledhjen e kryesoi Nait Hasani, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 09.06.2015;
3. Diskutim rreth vizitës së Komisionit në Berlin;
4. Shqyrtimi i Projektligjit për Provimin e Maturës Shtetërore;
5. Shqyrtimi i Projektligjit për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës;
6. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 09.06.2015

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 09.06.2015, u miratua pa vërejtje.

3. Diskutim rreth vizitës së Komisionit në Berlin;

Nait Hasani, tha se vizita realizuar në Berlin, me qëllim të njohjes me fushën e arsimit, kulturës, konsiderohet e dobishme, meqenëse kemi marrë përvoja të mira nga takimet e realizuara atje. Ai theksoi se sistemi dual i arsimit në Gjermani është një model i mirë i edukimit, sistemi shkollor me orar tërë ditë, ndërlidhja e sportit me edukim, konsiderohen forma të rëndësishme të cilat mund të aplikohen në vendin tonë mirëpo për shkak të çështjeve buxhetore kjo formë e arsimit kufizohet në vendin tonë.

Salih Morina, tha se kjo ka qenë një vizitë jashtëzakonisht e rëndësishme për ne. Nga vizita në Agjencinë Federale për Edukimin Qytetarë, kuptuam se Kosova ende ka nevojë të përmirësoj imazhin mirëpo mungon promovimi i kulturës dhe i fushave të tjera në arenën ndërkombëtare dhe do të ishte mirë që GIZ-i të na ndihmojë në këtë aspekt. Ai falënderoi GIZ-in për mbështetjen e ofruar dhe theksoi se secili takim ka qenë i rëndësishëm dhe ky bashkëpunim duhet të vazhdoj.

Srdjan Popović, falënderon GIZ-in për organizimin e kësaj vizite. Ai tha se vizita në përgjithësi ka qenë shumë e dobishme, nga takimet me institucionet atje kemi marrë përvoja të mira të cilat ne do të mund ti përdorim këtu për punën tonë në të ardhmen.

Shpejtim Bulliqi, falënderon GIZ-in për mbështetje dhe tha se vizita ka qenë shumë e suksesshme dhe me interes për të gjithë ne. Ai theksoi se brenda një vizite kemi arrit të njohim shumë segmente të funksionimit të sistemit arsimor gjerman por ka pas nevojë të kemi qasje dhe ti shohim për së afërmi edhe problematikat në arsimin profesional dhe tema në takimin që është zhvilluar në Universitetin e Postdamit do kishte qenë më mirë të ishte rreth procesit arsimor Universitar.

Ismajl Kurteshi, falënderon GIZ-in për përkushtimin ndaj Komisionit dhe mundësin e ofruar për të parë organizimin e sistemit arsimor në Gjermani por edhe pjesës publike në përgjithësi. Ai theksoi se organizimi ka qenë jashtëzakonisht në rregull por viza në ndonjë Parlament të ndonjë Republike Gjermane do të kishte qenë e dobishme.

Mufera Sinik, tha se vizita e Komisionit ka qenë e dobishme ku kemi marrë përvoja të mira lidhur me funksionimin e sistemit arsimor.

Shukrije Bytyqi, tha se secili takim e ka pas rëndësinë e tij, ne kemi marrë eksperiencë shumë të mira, jemi njohur sidomos me transparencën që ekziston atje dhe rëndësinë që i kushtohet fushës së arsimit. Ajo theksoi se ne na duhet përkrahja e GIZ-it në ngritjen e imazhit të Kosovës në Gjermani dhe në vendet tjera dhe këtë vërejtje do t'ua përcjellim Ministrisë së Diasporës dhe Ministrisë së Kulturës.

Bekim Haxhiu, tha se vizita ka qenë e qëlluara, na u është dhënë mundësia që për së afërmi të njihemi me sistemin arsimor gjerman në të gjitha nivelet. Ai theksoi se organizimi i sistemit dual në Kosovë është vështirë të realizohet sepse zhvillimi ekonomik është ende i ulët dhe duhet të kërkojmë mbështetje nga shtetet e Bashkimit Evropian që me potencialet financiare të orientohen kah zhvillimi ekonomik që pastaj të na mundësohet implementimi i këtij programi arsimor.

Nait Hasani, propozoi që në të ardhmen të kenë mundësi të shohin se si funksionon përgatitja e mësimdhënësve atje.

Dagmar Fuchs Schmitz, tha se ne kemi tentuar që vizitat ti bëjmë në përkatësi me nevojat e juaja dhe në përgjithësi gjithçka ka funksionuar mirë. Ajo theksoi se është me rëndësi që të përcaktoni se cilat elemente janë relevante dhe të aplikueshme që mund të jenë si orientim për të vazhduar bashkëpunimi i mëtejshëm në Kosovë.

Sokol Elshani, tha se nga bisedat e juaja i kemi përfshirë fushat me interes për ju, siç është transparenca në institucione, rritja e prezencës së Kosovës në publikime, zgjedhja pa ndikime politike në institucione, arsimi në sistemin dual, shkollat tërë ditore, integrimi i sportit në arsim, rritja e buxhetit për fushën e arsimit, ofrimi i mbështetjes në kuadër të ligjit për Inspektoratin e Arsimit dhe definimi i kriterëve për inspektor, rritja e numrit të testeve të jashtme dhe të brendshme të nxënësve, rritja e bashkëpunimit me fondacionin FES dhe ftimi e autoriteteve të atjeshme për konference këtu. Ai theksoi se këto janë çështje që do të ishte mirë të realizohen këtu me ndihmën e GIZ-it dhe përmes këtyre fushave të mund të kontribuohet edhe në institucionet e tjera.

Dagmar Fuchs Schmitz, pyeti se a ka edhe ndonjë pikë që mund të inkorporohet këtu.

Ismajl Kurteshi, tha se duhet të bëhet përpjekje për hapjen e sa më shumë çerdheve për fëmijë, të bëhet orientimi i hershëm i nxënësve për shkolla të mesme, të përmirësohet çështja e angazhimit të inspektorëve dhe mënyra e matjes së cilësisë, të hapen shkolla me qëndrim tërë ditore dhe të përmirësohen procedurat e pranimit në punë të mësimdhënësve. Në vazhdim ai theksoi se në Gjermani ishte e rregulluar shumë mirë mbikëqyrja e punës së mësimdhënësve dhe drejtorëve, organizimi i provimit të maturës dhe gërshtimi i autonomisë së institucioneve të arsimit dhe të kontrollit të shtetit edhe fondacionet ishin një mekanizëm që kontribuonin shumë në ngritjen e arsimit. Ai kërkoi që Kosova ta ketë mbështetjen e GIZ-it për hapjen e një Agjencioni për Edukim sepse kjo qendër do të ndihmonte shumë në edukimin dhe ngritjen e dijes së qytetarëve.

Nait Hasani, tha se duhet të bëhet ngritja e numrit të bursave dhe mundësisë të studimit jashtë vendit të nxënësve Kosovar. Ai propozoi që të bëhet edhe hapja e kurseve dhe qendrave gjermane në Kosovë dhe të futet gjuha gjermane në Universitete.

Dagmar Fuchs Schmitz, tha se shumë institucione ofrojnë bursa për nxënës nga Kosova, ndoshta ka pas mungesë informacioni përmes Universitetit por asnjë aplikacion nuk është dërguar nga nxënësit Kosovar.

Nait Hasani, tha se ka munguar informimi brenda Universitetit për këto mundësi.

Ismajl Kurteshi, tha se në këto raste nxënësve duhet tu jepet mundësi për parapërgatitje pra konkursi duhet të shpallet një vit më herët. Në vazhdim theksoi se është e rëndësishme për rritjen e bashkëpunimit me Gjermaninë hapja e Qendrave Kulturore në Kosovë.

Sokol Elshani, pyeti se në cilat çështje duhet të vazhdoj mbështetja e Komisionit nga GIZ-i.

Bekim Haxhiu, tha se GIZ-i duhet të ofroj mbështetje në krijimin e sistemit dual në arsim, tek Inspektorati dhe në ofrimin e ekspertëve për ligjet e arsimit.

Dagmar Fuchs Schmitz, tha se do ti shqyrtojmë kërkesat e juaja dhe do të shohim se në cilat fusha mund të ju mbështesim.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për Provimin e Maturës Shtetërore

Nait Hasani, tha se e kemi bërë amendamentimin e ligjit, sa i përket nenit 16, kemi propozuar që nxënësit që janë në shkollat profesionale dhe që nuk dëshirojnë të shkojnë në Fakultet ta marrin një diplomë që të jenë pjesë e tregut të punës ndërsa ata që dëshirojnë të vazhdojnë Fakultetin duhet ti nënshtrohen testit të maturës.

Bekim Haxhiu, propozoi që në mbledhjen e ardhshme të organizohet një punëtori dhe së bashku me përfaqësuesit e ministrisë të përfundohet amendamenti i këtij projektligji.

Nait Hasani, propozoi që të organizohen dëgjime publike edhe në tre regjioneve Ferizaj, Pejë dhe në Gjakovë.

5. Shqyrtimi i Projektligjit për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës

Nait Hasani, propozoi që të organizohet një dëgjim publik më 13 korrik për Projektligjin për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve dhe të ftohen faktorët e interesit në këtë fushë, akademikët, rektorët, dekanët e Universiteteve dhe përfaqësues nga Ministria.

Bekim Haxhiu, propozoi që të kërkohet nga GIZ-i dhe OSBE për mbështetje në ofrimin e një eksperti për këtë projektligj. Sa i përket projektligjit për Akademinë tha se me rastin e miratimit të ligjit do të duhej që edhe Statuti i Akademisë të shqyrtohet dhe miratohet në Kuvend siç është rasti me Statutet e Universiteteve Publike.

Shpejtim Bulliqi, tha se projektligji problem kryesor ka financat dhe dhënia e kompetencave për status pra është mirë që disa çështje që ata i kanë lënë vet ti determinojnë të rregullohen me ligj. Sa i përket ekspertit tha të jetë ekspert i jashtëm dhe propperëndimorë.

6. Të ndryshme

Ismajl Kurteshi, tha se ne kemi votuar bordin e Këshillit për Trashëgimin Kulturore dhe kërkoi që Kuvendi të deklarohet nëse do ta vendos në rivotim apo jo.

Nait Hasani, tha se e kemi bërë kërkesën nga sekretaria për këtë çështje mirëpo nuk kemi marrë ende përgjigje.

Ismajl Kurteshi, tha se me kërkesën e sekretarit të Kuvendit raportin e Agjencionit nuk e kemi shqyrtuar mirëpo ne si Komision duhet ta shqyrtojmë raportin dhe të vendosim nëse e aprovojmë apo jo dhe kërkoi që në mbledhjen e ardhshme të futet si pikë e rendit të ditës shqyrtimi i raportit të Këshillit për Trashëgimi Kulturore.

Bekim Haxhiu, tha se duhet ti kërkojmë kryesisë ose të procedohet ajo zgjedhje që kemi bërë ne ose të shpallet konkursi i ri në kuadër të Kuvendit.

Ismajl Kurteshi, tha se është në proces monitorimi i ligjit për Arsimin Parauniversitar dhe pyeti se a konsideron Komisioni të nevojshme organizimin e ndonjë eksperti.

Nait Hasani, tha se në bazë të praktikës asnjëherë nuk është angazhuar ekspert në fushën e monitorimit të ligjit.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Nait Hasani